



2537  
16.05.2016

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. Regj. Them. 7622/3028/860  
Dt. Regj. 01.10.2014

Nr. Vendimi 999  
Dt. Vendimi 04.05.2016

V E N D I M  
“Në emër të Republikës”

Gjykata Administrative e Apelit me trup gjykues të përbërë prej:

Kryesuese: Rilinda SELIMI  
Anëtar: Amarildo LAÇI  
Anëtar: Bari SHYTI

me sekretare gjyqësore **Mimoza LAZRI**, në Tiranë, sot më datë 04.05.2016 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative nr. 7622/3028/860akti, datë regjistrimi 01.10.2014 që u përket palëve ndërgjyqëse:

**PADITËS:** Shoqëria “Tomi” sh.p.k., me adrese ne Morave, Berat.  
**TË PADITUR:** 1. Drejtoria e Apelit, prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve.  
2. Drejtoria Rajonale Tatimore, Dega Berat.  
**OBJEKTI:** Konstatimi i pavlefshmerise absolute te akteve administrative “Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore”, me nr.4066 prot., date 7.12.2011, te Drejtorise Rajonale Tatimore Berat dhe vendimit me nr.23972/1 prot., date 19.3.2011, te Drejtorise se Apelit Tatimor Tirane. Pezullimi i zbatimit te akteve administrative.  
**BAZA LIGJORE:** Nenet 324/a, 329 e 331 te K.Pr.Civile ; ligji me nr. 9920 date 19.05.2008 “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”; udhezimi i Ministrit te Financave me nr.24, date 02.09.2008 dhe ligji me nr.8485. date 12.5.1999 i K.Pr.Administrative.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin Nr. 1523, datë 07.11.2012 ka vendosur:

1. *Rrëzimin e kërkespadi së si të pabazuar në prova e në ligj.*
2. *Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.*

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë, pala paditëse shoqëria “Tomi” sh.p.k., me të cilin ka kërkuar prishjen e vendimit dhe pranimin e padisë, për shkaqet:

- Akt konstatimi me datë 19.10.2011 dhe proces-verbali i gjobës, me nr.0031810, date 19.10.2011 janë përpiluar në kundërshtim me ligjin dhe përmbajnë deklarime të pavërteta.
- Konstatimi është bërë në mungesë të përfaqësuesit/administratorit të shoqërisë “Tomi” sh.p.k.
- Inspektorët nuk saktësojnë se çfarë pune po kryenin shtetasit Gentian Jaho, Altin Hajdari, Erion Hajdari, Bardh Hajdari, Mikel Sallaku në momentin e konstatimit. Ata nuk janë punonjës të shoqërisë “Tomi” sh.p.k.
- Shënimi në procesverbalin e gjobës “refuzon firmën” nuk vërteton faktin se tatimpaguesi ka qenë prezent, pasi në përmbajtje të procesverbalit konstatohet se rubrikat e emërtuara

Si u njoh me relatimin e gjyqtarës Rilinda Selimi, shqyrtoi aktet e dosjes dhe analizoi çështjen në tërësi:

## V Ë R E N

Pranë Gjykatës Administrative të Apelit është përcjellë për kompetencë gjykimi ligjshmëria e vendimit Nr. 1523, datë 07.11.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat mbi ankimin e shoqërisë "Tomi" shpk, palë paditëse.

Rezulton se ky vendim është dhënë mbi këto fakte e rrethana;

Paditësi shoqëria "Tomi" shpk është person juridik me seli në fshatin Morave, Komuna Otlak, Berat, me NIPT K72515003U dhe ushtron veprimtari tregtare me objekt: import, eksport, tregetim me shumice e pakice të artikujve të ndryshëm, punime ndertimi, etj.

Inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat, në datë 19.10.2011, kanë ushtruar kontroll në lagjen "18 Tetori", Ura Vajgurore dhe kanë perpiluar akt konstatimin me datë 19.10.2011, ku ndër të tjera kanë theksuar: *"... grupi i punës shkoi në subjekt dhe konstatoi se në momentin e kontrollit u gjetën duke punuar në banesë tre kate + bodrum, me investitor Kristo Gole, ndertues "Tomi" shp.k., persona të cilët sipas deklarimeve të tyre janë Gentian Jaho, Altin Hajdari, Erion Hajdari, Bardh Hajdari, dhe Mikel Sollaku dhe se këta punëtorë në momentin e kontrollit deklarojnë se punojnë për firmën "Tomi" sh.p.k."*

Nga kontrata e punës Nr. 3573 Rep. Nr. 1610 Kol. Datë 10.10.2011, rezulton se Albert Tabaku është punësuar si karpentier pranë shoqërisë "Tomi" sh.p.k. Periudha e punësimit është nga data 18.10.2011 deri në 18.10.2012.

Nga kontrata e punës Nr. 167 Rep. Nr. 359 Kol. Datë 08.02.2011, rezulton se Mikelin Sollaku është punësuar si karpentier dhe hekurkthyes pranë shoqërisë "Tomi" sh.p.k. Periudha e punësimit është nga data 03.02.2011 deri në 02.08.2011.

Me memon Nr. 2472 Prot. datë 06.12.2011 nga inspektorët e vlerësimit është kërkuar miratimi i vlerësimit tatimor për subjektin "Tomi" sh.p.k.

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat me aktin administrativ "Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore", me nr.4066 prot. datë 07.12.2011, detyron paditësin të paguajë "Tatim" në shumën 11.414 lekë, "Kamatëvonesë" në shumën 68 lekë dhe "Gjobë" në shumën 501,142 lekë, gjithsej 512.624 lekë.

Paditësi rezulton të ketë bërë ankim në Drejtorinë e Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme Tiranë. Me vendimin nr.23972/1 prot, datë 19.03.2012, Drejtoria e Apelit Tatimor, Tiranë ka vendosur: Refuzimin e ankimit për shkak se e konsideron ankimin të papranueshëm pasi nuk është vërtetuar pagesa e detyrimeve të përcaktuara në aktin administrativ, Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore nr.4066, datë 07.12.2011.

Këto akte, bazohen në akt konstatimin me datë 19.10.2011 dhe proces-verbalin e gjobës, me nr.0031810, datë 19.10.2011, me të cilin është vendosur dënimi i shoqërisë "Tomi" sh.p.k me gjobë në shumën 500.000 lekë në bazë të nenit 119 të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH" pasi rezultojnë 5 punëtorë të pa deklaruar (regjistruar).

Më datë 24.05.2012 paditësi i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të njoftim vlerësimit për detyrimet tatimore nr. 4066 prot. datë 07.12.2011 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat si dhe të vendimit të Drejtorisë së Apelit Tatimor për lënien e tij në fuqi.

dhe njoftim vleresimi, pala paditese nuk paraqiti prova qe te provonte faktin se ata jane punetore te deklaruar, te rregjistruar. Pretendoj se keta punonjes i perkasin nenkontraktorit, personit fizik Mikelin Sollaku, me te cilin ka nenshkruar nje kontrate pune nga 3.2.2011 deri ne 2.8.2011. Kontrata e punes e lidhur midis punedhenesit shoqeria "Tomi" shpk dhe punemarresit Mikelin Sollaku eshte mbajtur me date 8.2.2011 dhe ne te fiksohet: "afati ka filluar sot me date 3.2.2011 dhe do te mbaroje me date 2.8.2011". Procesverbali i gjobes eshte mbajtur me date 19.10.2011. Pra, afati ka mbaruar me pare se te jete bere procesverbali i gjobes. Me tej, me date 18.10.2011, ka kontraktuar me personin fizik Albert Tabaku, i cili ka faturuar punimet e shoqerise "Tomi" shpk.

Pala paditese, paraqiti fatura te thjeshta tatimore, ku ato me nr.2857131 dhe 2857133 jane te nenshkruara nga Mikelin Sollaku dhe Tomor Duci. Faturat nuk jane te konfirmuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, gje qe do te thote se ato nuk e kane vleren e proves. Prej pales paditese u paraqiten edhe fatura te tjera tatimore si ato me date 30.1.2011, 28.2.2011, 15.4.2011, 5.3.2011, 30.5.2011, 25.6.2011, 30.8.2011, 30.9.2011, 15.10.2011, te pakonfirmuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, pervec te pares, e cila eshte e panenshkruar ne rubrikat "emeri dhe nenshkrimi i shitesit" si dhe ne "emeri dhe nenshkrimi i blesesit". Pra, ne provat e paraqitura nga paditesi, nuk vertetohet se punonjesit, shtetasit Gentian Jaho, Altin Hajdari, Erion Hajdari, Bardh Hajdari, Mikel Sollaku, per te cilet eshte penalizuar subjektin "Tomi", shpk, te jene siguruar nga subjekti, personi fizik Mikelin Sollaku.

Sa me siper, gjykata konkludon se paditesi nuk legjitimohet ne kerkimin e tij ne baze te neneve 324/a, 329 e 331 te K.Pr.Civile, ligjit 9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", Udhezimit te Ministrit te Financave nr.24, date 02.09.2008 dhe ligjit nr.8485, date 12.5.1999 K.Pr.Administrative, dhe si e tille padia e tyre duhet te rrezohet si e papabazuar ne prova e ne ligj".

**Kolegji Administrativ i Apelit, si vlerësoi materialet e çështjes cmon se pretendimet e ngritura në ankim nga pala paditëse nuk përmbajnë shkaqe ligjore për cenimin e vendimit objekt ankimi me anën e të cilës Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur rrëzimin e padisë.**

Pala paditëse kundërshton detyrimet e përmbajtura në njoftim vlerësimin tatimor nr. nr.4066 prot. datë 07.12.2011 akt i cili rezulton i pacënuar nga Drejtoria e Apelit Tatimor, refuzuar ankimi i palës paditëse pasi nuk është vërtetuar pagesa e detyrimeve të përcaktuara në aktin administrativ. Pretendimet e palës paditëse se ky akt administrativ është absolutisht i pavlefshëm sipas gërmës "b" të nenit 116 të K.Pr.Administrative janë pa mbështetje ligjore.

Në këtë dispozite përcaktohet se:

*"Aktet administrative do te quhen absolutisht te pavlefshme ne kuptim te ketij Kodi ne rastet e meposhtme:*

- a) Kur akti eshte nxjerre nga nje organ administrativ i paidentifikuar.*
- b) Kur akti administrativ eshte nxjerre nga nje organ administrativ ne kapercim te kompetencave te tij ligjore.*
- c) Kur akti eshte nxjerre ne kundërshtim me formen ose proceduren e kerkuar nga ligji".*

Në shqyrtimin e ligjshmerise se vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, Kolegji Administrativ i Apelit mban ne konsiderate Vendimin Unifikues nr. 3, datë 12.02.2008 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pika 38.3, ku thuhet se: ".....nëse pretendohet pavlefshmëria absolute e akteve, kërkim që nuk është i ndërruar nga ndonjë afat parashkrimi, gjykata, nuk mund të nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, por në zbatim të nenit 121 të

verifikuesit dhe urdhrin e ditës, te lëshuar nga drejtuesi i drejtorisë së kontrollit për verifikime në vend.”

Pretendimet e paditësit për pavlefshmëri absolute të njoftim vlerësimit tatimor me argumentimin se në momentin e kontrollit nuk ka qënë prezent përfaqësuesi i shoqërisë janë të papranueshme. Sikurse më sipër cituar verifikimi në vend nuk mund të pengohet nga prania e përfaqësuesit të subjektit tatimpagues. Kjo formë kontrolli kryhet pa njoftim paraprak në vendin e ushtrimit të aktivitetit dhe si e tillë është e ndryshme nga ajo e kontrollit tatimor rregulluar sipas nenit 81 e vijues të ligjit.

Ndaj edhe pretendimet e palës paditëse për mosnjoftim paraprak dhe dërgim të raport kontrollit me qëllim paraqitjen e observacioneve brenda 5 ditëve, janë rregullime tej kësaj forme kontrolli, verifikim në vend e si të tilla pa bazë ligjore.

Pretendimet e palës paditëse në lidhje me mohimin e të drejtës së saj për t’u dëgjuar në gjykimin administrativ të zhvilluar nga Drejtoria Rajonale Tatimore gjithashtu cmohen të pabazuara. Mosshqyrtimi i ankimit është rrjedhojë e mosplotësimit të kërkesave të ligjit, nenit 106 e vijues të ligjit nr. 9920/2008 ndaj nuk kanë vend pretendime për mosmarrjen e shpjegimeve dhe informacioneve në këtë procedurë.

Kolegji vlerëson se pretendimet e palës paditëse se nuk është ajo punëdhënëse e personave të cituar në akt konstatimi apo se nuk cilësohet çfarë punë ishin duke kryer efektivisht, nuk japin një qëndrim konsistent të palës paditëse e aq më tepër nuk përbëjnë shkaqe të pavlefshmërisë absolute të aktit. Kolegji cmon veprimet e kryera nga inspektorët tatimore në ushtrim të detyrave të tyre funksionale dhe dokumentuar në përputhje me ligjin.

Në përfundim Kolegji Administrativ i Apelit konkludon se nuk ka shkaqe ligjore për çënimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat për rrëzimin e padisë si të pabazuar në prova dhe në ligj. Si i tillë vendimi duhet lënë në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Administrative e Apelit, mbështetur në nenin 50, gërma “b” të Ligjit nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”,

### **V E N D O S I**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 1523 datë 07.11.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.
2. Kundër vendimit nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë brenda 30 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të tij.

**U shpall në Tiranë, sot më datë 04.05.2016.**

**ANËTAR**  
**Bari SHYTI**  
(d.v)

**ANËTAR**  
**Amarildo LAÇI**  
(d.v)

**KRYESUESE**  
**Rilinda SELIMI**  
(d.v)

E njesuar me origjinalin

Kancelari  
Leonard Shkurtaj  
Shkurtaj